

BULETIN MUJOR

Publikohen:

✓ **Rregullorja e Maturës Shtetërore 2026**

✓ **Datat e provimeve të Maturës Shtetërore**

Publikohet rregullorja dhe kalendari i provimeve të Maturës Shtetërore 2026

Është bërë publike rregullorja e Maturës Shtetërore 2026, si edhe kalendari zyrtar i provimeve për të gjithë maturantët që ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional. Provimi i gjuhës së huaj do të zhvillohet më 2 qershor, provimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë më 9 qershor, provimi i matematikës më 16 qershor, ndërsa provimi me zgjedhje më 23 qershor. Paralelisht, janë publikuar dhe shpërndarë edhe testet model, të cilat shërbejnë për orientimin dhe përgatitjen sa më të mirë të maturantëve gjatë gjithë procesit të studimit.

Mblidhet Konferenca e Rektorëve; 11.2 miliardë lekë në mbështetje të institucioneve të arsimit të lartë

Është mbajtur mbledhja e parë për vitin 2026 e Konferencës së Rektorëve, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama dhe Ministres së Arsimit, Mirela Kumbaro. Ministria Kumbaro bëri me dije miratimin e granteve prej 11.2 miliardë lekësh për institucionet publike të arsimit të lartë. Në këtë takim me 40 rektorë të universiteteve publike e private u nënvizua rëndësia e lidhjes së kërkimit shkencor me tregun e punës, inovacionin dhe procesin e integritetit evropian.

Ministria Kumbaro takime me agjencitë e Ministrisë së Arsimit për cilësinë, investimet dhe prioritetet 2026

Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro zhvilloi disa takime me stafet drejtuese, ekspertët dhe specialistët e institucioneve përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe atë të lartë. Gjatë takimeve për arsimin parauniversitar, u diskutua përgatitja për provimet e maturës shtetërore dhe atyre kombëtare, kurrikulat e reja dhe përditësimi kurrikular i 140 teksteve mësimore. Në fokus të takimeve për arsimin e lartë ishin investimet në infrastrukturën e kërkimit shkencor, financimi i kërkimit shkencor akreditimi i programeve të studimit, etj.

Nis Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe

Ka nisur edicioni i katërt i Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe, ku nxënësit e klasave të IX-ta në shkollat e gjithë vendit testojnë njohuritë, mendimin kritik, korrektësinë gjuhësore dhe të nxisë aftësi më të mira të komunikimit. Konkursi, i cili shënon një pjesëmarrje të gjerë në shkolla, ka si qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve shqiptarë dhe institucioneve mbi rëndësinë e ruajtjes, mbrojtjes dhe trashëgimisë së gjuhës shqipe.

Për herë të parë, Festivali Kombëtar i Shkencës

Ka nisur përgatitja e nxënësve në shkollat e vendit për Festivalin Kombëtar të Shkencës. Ky festival zhvillohet për herë të parë dhe është një nga nismat më të rëndësishme të këtij viti shkollor, ndërsa të gjitha shkollat e arsimit të mesëm të lartë janë njohur me udhëzuesin zyrtar për organizimin e tij. Në Festivalin Kombëtar të Shkencës do të marrin pjesë shkollat e mesme, duke u kthyer në një konkurs dhe hapësirë ku talentet e reja shkencore marrin vëmendjen që meritojnë.

